

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

ALFA COURIER SERVICES

Sot, më datë 15.03.2021, personalisht:

- **Alket KUTROLLI**, i biri i Pëllump-it, i datëlindjes 25.06.1982, shtetas shqiptar, lindur ne Bilisht dhe banues ne Rruga Superstrada Devoll, Nr.3, Bilisht, Devoll, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, me cilësinë e ortakut të shoqërisë tregtare ALFA COURIER SERVICES Sh.p.k.
- **Fredi KUTROLLI**, i biri i Pëllump-it, i datëlindjes 05.01.1976, shtetas shqiptar, lindur ne Bilisht dhe banues ne Sheshi Qendoror Bilisht, L2, Nr.1 Bilisht, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, me cilësinë e ortakut të shoqërisë tregtare ALFA COURIER SERVICES Sh.p.k.
- **Mertiaz SPAHIU**, i biri i Eqrem-it, i datëlindjes 10.09.1972, shtetas shqiptar, lindur ne Korçë dhe banues ne Blloku Demokracia, L7, Nr.2, Korçë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, me cilësinë e ortakut të shoqërisë tregtare ALFA COURIER SERVICES Sh.p.k.
- **Pandush LAKO**, i biri i Guri-t, i datëlindjes 24.11.1992, shtetas shqiptar, lindur ne Korçë dhe banues ne Sheshi i Teatrit, L9, Nr.14, Korce, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, me cilësinë e ortakut të shoqërisë tregtare ALFA COURIER SERVICES Sh.p.k.

Përpilojnë këtë akt themelimi të shoqërisë tregtare **ALFA COURIER SERVICES sh.p.k.**, me termat e mëposhtme:

NENI 1

Të themelojnë Shoqerinë Tregtare ALFA COURIER SERVICES Sh.P.K, në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria kundrejtuar të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri ALFA COURIER SERVICES Sh.P.K, ose emri tregtar sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe në Statut.

NENI 2 Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit ekonomik në fusha të ndryshme. Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë thellësisht me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

NENI 3 Emri dhe vula e shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin e subjektit ALFA COURIER SERVICES Sh.P.K dhe me emrin tregtar ACS. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

NENI 4 Objekti i veprimitarisë

Veprimitaria e shoqërisë do të jetë:

- Marrjen, grumbullimin dhe shperndarjen e kolive, pakove dhe zarfave normale dhe exspres te te gjitha llojeve dhe madhesive, brenda dhe jashtë territorit te Republikës se Shqiperise me ane te transportit tokesore, detar dhe ajror.
- Poste e shpejte, transport i porositur, transport i kombinuar, te veproje si agjent dergues dhe transportues.
- Agjensi doganore, magazinim doganor, sherbime doganore, sherbime magazinimi, sherbime arkivimi.
- Veprimitari e agjentit per transferte parash apo per sherbimin e pagesave per vete apo te trete ne emer dhe per llogari te një subjekti financiar jobanke si dhe veprimitari e agjentit komisioner.
- Shoqeria mund te ndermanre dhe zhvilloje cdo lloj aktiviteti me qellim tregtar, financiar, qiradhenes apo dorezanes, qe i vlereson te dobishme apo te nevojshme per arritjen e qellimeve te veprimitarisë se saj.
- Perfaqesimi ne Shqiperi i shoqerive te huaja dhe shqiptare dhe i ndermarrjeve qe kane objekt te njejtë apo te perafert dhe bashkepunimi me to ne cfaredo lloj forme etj.

NENI 5 Selia e Shoqërisë dhe Afati

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Autostrada Tirane-Durres, Km.10, Rruga Dytësore Vore. Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një periudhe kohore pa afat.

NENI 6 Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 3.000.000 (tri million) Lekë.

Numri total i kuotave: 4.

NENI 7

Pjesëmarrja ortakeve në kapitalin e shoqërisë jane në përputhje me kontributet ne para si më poshtë:

- Alket KUTROLLI pjesemarrja ne perqindje 15 %, 1 kuotë, lloji i kontributit para, 450.000 (katerqind pesedhjete mijë) Leke, kontribut i cili eshte nenshkruar dhe nuk eshte paguar.
- Fredi KUTROLLI pjesemarrja ne perqindje 15 %, 1 kuotë, lloji i kontributit para, 450.000 (katerqind pesedhjete mijë) Leke, kontribut i cili eshte nenshkruar dhe nuk eshte paguar.
- Mertiaz SPAHIU pjesemarrja ne perqindje 30 %, 1 kuotë, lloji i kontributit para, 900.000 (nenteqind mijë) Leke, kontribut i cili eshte nenshkruar dhe nuk eshte paguar.
- Pandush LAKO pjesemarrja ne perqindje 40 %, 1 kuotë, lloji i kontributit ne para, 1.200.000 (nje milion dyqind mijë) Leke, kontribut i cili eshte nenshkruar dhe nuk eshte paguar

NENI 8 Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

NENI 9 Administratori

Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit i cili zgjidhet për një mandat 4 (kater) vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Administratori i parë i shoqërisë do të jetë **Z. Pandush Guri LAKO**.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretë nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përrputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 10

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mund të vendose për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 11

Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre.

NENI 12

Mosmarrveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

NENI 13

Akti i themelimit pasi u lexua nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve u get sipas vullnetit të tyre dhe u nënshkrua pa vërejtje. Akti i Themelimi hartoher në gjuhën shqipe.

Emri dhe nënshkrimi i Ortakeve themelues

Alket KUTROLLI

Alket Kutrolli

Mertiaz SPAHIU

Mertiaz Spahiu

Fredi KUTROLLI

Fredi Kutrolli

Pandush LAKO

Pandush Lako